

REPublika e Kosovës
REPublika KOS
Qendra për Shërbim të Qytetarëve
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 3272
U. Br.

Nr. i faq. 3 Data: 10/10/2025
Br. str. KAMENICË/A



REPublika e Kosovës
REPublika KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Procesverbali i mbajtjes së konsultimit publik për Draft-Rregulloren për Themelimin dhe Punën e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Komunën e Kamënicës.

Takimi publik është organizuar nga Grupi Punues për Draft-Rregulloren për Themelimin dhe Punën e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Komunën e Kamënicës.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Eëbfaqen Komunale dhe në Facebook zyrtar të Komunës së Kamënicës.

Publikimet:

WEBFAQE:

<https://kamenice.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/1658.pdf>

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid02QSxFGz8bTFV4bEJA7TNzZJFcITGYiTzFMbD1c7a53AyFrtfPHbës8WFFUamcYGRsl>

Me 06.02.2025 konsultimi publik është mbajtur me qytetarë në Sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në këtë konsultim ishin: anëtarët e grupit punues, Drejtor të Shkollave të Kamënicës, nxënës të shkollave, zyrtar komunal.

Shqyrtimin e hapi Kryesuesja e Grupit Punues, Nazmije Demolli-Kastrati ku falënderoi të pranishmit dhe i dha fjalën Drejtorit të Arsimit, Afrim Dervishi.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Dervishi: Kryetari Kadri Rahimaj ka vullnet të plotë që për fëmijët tanë ta bëjë maksimumin sidomos për mirëqenien e tyre. Në shkolla bëhet shumë punë por ka edhe punë që nuk shkruhen, dhe për këtë ndoshta edhe nuk duken, andaj ky dokument përcakton saktë detyrën prej drejtorit të arsimit, drejtorëve të shkollave, nxënësve, me iden që t'iu ndihmojmë për ndërtimin e një personaliteti që do t'iu duhet në të ardhmen. Pra me këtë Rregullore fëmijët kultivojnë personalitetin duke filluar nga pjesëmarrja pastaj të shprehurit, dhe për të gjitha ato që i keni bërë deri më sot po i rregullojmë me ligj që të dëgjohet zëri juaj.

Kryesuesja e grupit punues të këtij dokumenti, Nazmije Demolli-Kastrati, ka paraqitur në pika të shkurtra Rregulloren: Rregullorja përfshinë 24 nene ku janë të cekura të gjitha që kanë të bëjnë me Asamblesë Komunale të Fëmijëve. Qëllimi i themelimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve është edukimi i fëmijëve për proceset vendimmarrëse dhe avancimit e të drejtave të tyre. Kjo asamble u mundëson fëmijëve të shprehin mendimet, shqetësimet dhe propozimet në lidhje me çështjet që ndikojnë në jetën e tyre shkollë. Ajo ndihmon gjithashtu në zhvillimin e aftësive të fëmijëve për të qenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, duke i angazhuar ata në aktivitete që promovojnë drejtësinë, barazinë dhe mirëqenien e fëmijëve.

Obligimet dhe detyrat e Asamblesë janë : të parashtrojnë kërkesa, të japin mendime dhe sugjerime për institucionet relevante komunale, për Këshillat e Shkollës, Këshillat e Prindërve dhe drejtoritë lidhur me zbatimin e rregulloreve të sjelljes në shkollë, planin zhvillimor të shkollës, aktivitetet e lira, pjesëmarrjen në aktivitete kulturore-artistike, konkurse të ndryshme dhe organizimin e të gjitha manifestimeve të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj në interes të fëmijëve; të kërkojnë avancimin e bashkëpunimit të nxënësve dhe mësuesve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional; të informohen rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për jetën e tyre shkollë.

Pas prezantimit të dokumentit është hapur debati për pyetje dhe përgjigje nga të pranishmit.

Pyetjet/Sugjerimet e të pranishmëve për dokumentin në fjalë:

Nxënësja: Sa herë kemi të drejt të mbajmë mbledhje Këshilli Drejtues?

Afrim Dervishi: Varësisht prej çështjeve që ka Këshilli thërret mbledhje.

Nxënësja: A ka mundësi të rriten aktivitetet shkollë si më shumë kuize në mënyrë që t'i rrisim më shumë njohuritë?

Afrim Dervishi: Ka shumë mundësi dhe drejtorët i kanë të gjitha. Është duke u punuar të bëhet plani vjetor i aktiviteteve të shkollave.


Nxënësja: A ka mundësi të kemi ligjërata për të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi dhe ngacmimi ku Asambleja të organizojë një mjedis më mbrojtës?

Afrim Dervishi: Jeta juaj është e garantuar, si jetoni, ushqimi të gjitha janë të garantuara. Ju i keni këto të drejta dhe nuk duhet kërkuar t'i keni pasi që ekzistojnë ato janë të

garantuara, vetëm duhet të punojmë bashkë që përmes Asamblesë të identifikojmë që nëse nuk realizohen këto të drejta të marrim masa.

Takimi ka mbaruar në orën: 11:00.

Procesmbajtës:

A handwritten signature in black ink, written over a horizontal line. The signature is stylized and appears to be a name followed by a surname.